VENDIM
Nr.4, datë 20.10.2006

PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË SEKTORIN E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT, ULLIRIT, RRUSHIT DHE BLUARJES SË GRURIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin "Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit, rrushit dhe bluarjes së grurit". Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.Al/009/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore",

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore".

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet të administrojnë të dhënat për secilën nga ndërmarrjet që kanë përfituar duke llogaritur, njëkohësisht, edhe vlerën totale të ndihmës.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të analizojë me imtësi efektet e ndihmës së dhënë, duke bërë një balancë midis efekteve pozitive në drejtim të rritjes së sasisë, cilësisë dhe sigurisë së produkteve të përpunuara në treg, si dhe efektit negativ në konkurrencë, për të pasur një vizion më të qartë nëse kjo skemë i ka arritur ose mund t'i arrijë në të ardhmen objektivat që ajo ka, duke dëmtuar sa më pak konkurrencën në treg.

3. Vlera maksimale e totalit të skemës, për secilin nga nënsektorët, nuk duhet të kalojë në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së. Ky intensitet të llogaritet mbi bazën e akumulimit edhe të formave të tjera të ndihmës, të zbatuara për këta nënsektorë.

KRYETARI
Genc Ruli